



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 625 Prot.

Tiranë, më datë 29.05.2020

VENDIM

Nr. 133, datë 29.05.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48 dhe neni 134, pika 1, dhe V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë në Këshillin Teknik të projektit dhe koncept sondazhit arkeologjik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 29.05.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Sondazhe arkeologjike dhe gjeologjike të ndërhyrjes paraprake në Kullën C në Durrës” dhe koncepti i sondazheve arkeologjike për objektin “Kulla C-projekti i rehabilitimit Faza I”, realizuar nga shoqëria e licencuar në arkeologji “AD-STAR” sh.p.k., me aplikues CHWB;
2. Subjekti CHWB duhet të kryejë sondazhet arkeologjike në bashkëpunim me subjektin e licencuar në arkeologji “AD-STAR” sh.p.k sipas konceptit të miratuar dhe DRTK Tiranë do të mbikëqyrë në mënyrë periodike ditore kryerjen e sondazheve arkeologjike për projektin e sipërcituar.
3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 144-147;
 1. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
 2. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

KRYETAR

Elva MARGARITI

